



INFORMATA BAZIKE:

Lajmëruesit e Dezinformatave – Monitorimi i Mediave Ruse është një raport mujor i lajmeve që përmbajnë dezinformata dhe keqinformime që e vëjnë në shënjestër Kosovën, dhe që janë të botuara në mediat ruse në gjuhën angleze dhe serbe

PËRKRAHUR NGA:



Londër, Mbetëria e Bashkuar

VËREJTJE:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED).

KONTAKTI:

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)
Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1
10 000 Prishtina, Kosovo
Tel: +383 (0)38 542 778
Web-site: www.kipred.org
Email: info@kipred.org

LAJMËRUESIT E DEZINFORMATAVE PËR KOSOVËN

MEDIAT RUSE

SHKURT 2020

HYRJE

Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën: Monitorimi i Mediave Ruse, synon t'i kundërvihet dezinformimit që e vë në shënjestër Kosovën, përmes vëzhgimit në një bazë mujore të botimeve mediale të përzgjedhura të dala në Rusi, si në gjuhën angleze, ashtu edhe në atë serbe. Mediat e përzgjedhura në gjuhën angleze janë Russia Today, Sputnik, Meduza, Russia Insider, TASS, The Moscow Times, Newsfront, Unz, The Duran dhe Pravda Report, ndërsa në gjuhën serbe është Sputnik Serbia. Pas kësaj, Lajmëruesi i Dezinformatave i monitoron lajmet, dokumentet dhe deklaratat që kanë të bëjnë me Kosovën, të publikuara nga Kremli dhe nga Ministria Ruse e Punëve të Jashtme.

Gjatë shkurtit 2020 Russia Today i ka botuar pesë lajme, Sputnik një, Meduza asnjë, Russian Insider dy, TASS një, The Moscow Times, Newsfront gjashtë, Unz një, The Duran dhe Pravda Report asnjë lajm, ndërsa Sputnik Serbia i ka botuar 132 lajme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë janë të ndërlidhura me Kosovën. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe mbikëqyrëse, në ueb-sajtet e tyre Kremli e ka patur një, dhe Ministria e Jashtme Ruse tri postime të ndërlidhura me Kosovën.

Një shqyrtim i kujdesshëm i lajmeve të mbikëqyrura tregon se lajmet e botuara në gjuhën angleze nga mediat e dhëna më sipër me seli në Rusi gjatë shkurtit 2020 nuk kanë patur përmbajtje dezinformuese, dhe, po ashtu, edhe Sputnik Serbia nuk e ka pasur asnjë artikull që ka mundur të klasifikohet si dezinformim, edhe pse disa prej tyre kanë pasur përmbajtje me keqinformim. Nga ana tjetër, Kremli i ka pasur dy lajme pa përmbajtje dezinformuese, ndërsa Ministria e Punëve të Jashtme e Federatës Ruse ka patur postime me përmbajtje me dezinformime serioze.

Dezinformatat e bëra nga Ministria e Jashtme Ruse, synojnë qartë që ta paraqesin një pamje të mjegulluar të pozitës së komunitetit serb dhe të gjendjes ndëretnike në Kosovë. Kjo bëhet me qëllim të paraqitjes së Kosovës si një shtet që i shtyp komunitetet pakicë dhe që e ka një potencial të lartë të shpërthimit të dhunës etnike, si dhe për t'ia rrënuar themelet, si shtetësisë së Kosovës, ashtu edhe përkrahjes së Perëndimit për të. Dezinformata e detektuar në këtë periudhë do të diskutohet dhe dekonstruktohet në seksionin vijues.

DEKONSTRUKTIMI I DEZINFORMATAVE TË DETEKTUARA

Lajmëruesi i Dezinformatës 1

Titulli: Raport: Gjendja e të Drejtave Njerëzore në një numër vendesh, Ministria e Punëve të Jashtme e Federatës Ruse, Moskë, 7 shkurt¹, 2020.

Më 7 shkurt 2020, Ministria Ruse e Punëve të Jashtme e botoi një raport për të Drejtat e Njeriut në një numër vendesh, në të cilin një pjesë e veçantë për vende i kushtohet edhe Kosovës. Në këtë pjesë ky botim e paraqet një pamje të zyrtë të vendit që ka të bëjë fare pak me realitetin e tij. Meqë raporti është i mbushur përplot me pretendime, shumica më e madhe e të cilave nuk mbështeten me burimet përkatëse (janë përmendur vetëm tre burime të referencave), ne do të përqendrohemi në dy raste të dezinformimeve flagrante.

Raporti fillon me pohimin: “Në vitet 2017–2019, gjendja e të drejtave të njeriut në “Republikën e Kosovës” së vetë-shpallur, ka vazhduar të jetë një shqetësim i madh i bashkësisë ndërkombëtare për shkak të incidenteve dhe shkeljeve të shumta që kanë kërcënuar të përshkallëzohen në shpërthime masive të dhunës nga nacionalistët shqiptarë të Kosovës kundër pakicës serbe dhe pakicave të tjera.”

Për më tepër, ndër të dhënat dhe interpretimet e tjera të rreme që janë paraqitur, është edhe pohimi që “OJQ-ja serbe e Kosovës “Aktiv” raporton se midis shtatorit 2017 dhe shtatorit 2018 kanë ndodhur më shumë se 50 vrasje të serbëve të Kosovës.”

¹ Human Rights situation in certain countries [Të Drejtat Njerëzore në disa vende], Raport i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Federatës Ruse, Moskë, 7 shkurt 2020:

https://www.mid.ru/en/web/guest/foreign_policy/humanitarian_cooperation/-/asset_publisher/bB3NYd16mBFC/content/id/4025481#46

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

a) Incidentet që kërcënuan për t'u përshkallëzuar në shpërthime masive të dhunës së nacionalistëve shqiptarë të Kosovës kundër pakicës serbe dhe pakicave të tjera kombëtare

Ky pohim nuk pajtohet me situatën në terren në Kosovë, e cila që nga trazirat e marsit 2004 nuk është përballur me kurrfarë incidentesh të mëdha ndër-etnike. Për më tepër, po të njëjtat raporte të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të KB (SRSG), të cilat në raport citohen në mënyrë anuese, nuk e përkrahin një pohim të tillë. Pos kësaj, edhe përkundrejt tendosjeve të herëpashershme midis Kosovës dhe Serbisë, marrëdhëniet ndër-etnike gjatë periudhës së vështruar në raport kanë mbetur stabile, pa kurrfarë shenjash të çfarëdo shpërthimi të çfarëdo qoftë dhune masive.²

b) OJQ-ja serbe e Kosovës "Aktiv" raporton që midis shtatorit 2017 dhe shtatorit 2018 kanë ndodhur më shumë se 50 vrasje të serbëve të Kosovës

Ky pohim nuk mbështetet nga kurrfarë të dhënash të besueshme, përfshirë edhe ato të dhëna nga OJQ-ja e vlerësuar serbe e Kosovës "Aktiv,"³ Policia e Kosovës, dhe as nga raportet periodike të SRSG-së për Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Për më tepër, sipas të gjitha këtyre raporteve, mund të konstatohet fare lehtë që në Kosovë nuk është regjistruar as edhe një rast i vetëm i çfarëdo vrasjeje ndëretnike.⁴

² Për një dokumentim të mëtutjeshëm të këtij pohimi shih, për shembull, Raportet e Sekretarit të Përgjithshëm të KB për Misionin e KB të Administrimit të Kosovës (2017-2019), <https://unmik.unmissions.org/sg-reports>.

³ Për një hetim të mëtejshëm shih botimet e OJQ-së Aktiv të disponueshme në: <http://ngoaktiv.org/publications>

⁴ Për një dokumentim të mëtutjeshëm të këtij pohimi shih, për shembull, Raportet e Sekretarit të Përgjithshëm të KB për Misionin e KB të Administrimit të Kosovës (2017-2019), <https://unmik.unmissions.org/sg-reports>

Lajmëruesi i Dezinformatës 2

***Titulli:** Konferencë shtypi nga Zëdhënesja e Ministrisë së Jashtme, Maria Zakharova, Moskë, 27 shkurt 2020: Prokurori Special i Zyres me seli në Hagë të Dhomave të Gjykatës Speciale, Jack Smith i gatshëm për të nisur procedurat si pjesë e hetimit për krimet e shqiptarëve të Kosovës.*

Në konferencën e saj për shtyp Zakharova pohoi: “Ne besojmë fuqishëm që heshtja e krimeve mizore në Kosovë dhe lënja e tyre pa u hetuar dhe pa u dënuar është e papranueshme. Marrja e ndaluar e organeve është një çështje që duhet të shqyrtohet nga bashkësia botërore. Ajo që është në lojë është reputacioni i sistemit ndërkombëtar të drejtësisë, Bashkimi Evropian si garantues që gjykata speciale do ta kryej punën e vet dhe aftësia e përgjithshme e institucioneve evropiane për ta vlerësuar realitetin siç duhet. Të gjithë individët e përfshirë duhet të pësojnë ndëshkime të vrazhda, pavarësisht nga pozitat që për momentin e mbajnë në Prishtinë.

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

a) Heshtja e krimeve mizore në Kosovë

Në akuzat e saj kundër Gjykatës Speciale të Kosovës, Zakharova e shpërfill faktin që deri në fundin e vitit të kaluar më shumë se 200 qytetarë të Kosovës janë marrë në intervista nga Prokurorët e Gjykatës,⁵ gjë kjo që është një dëshmi e qartë që Gjykata nuk është duke i heshtur krimet e pretenduara.

Për më tepër, ajo ia kushtoi një theks të veçantë “marrjes së organeve” që pretendohet, e për të cilën, sipas Prokurorit Kryesor të Forcës Speciale Hetuese, Clint Williamson, “ka indikacione bindëse që kjo praktikë ka ndodhur në një shkallë tejet të kufizuar, dhe që një numër i vogël i individëve janë vrarë me qëllim të marrjes dhe shitjes së organeve të tyre ..., dhe që një numër i

⁵ Shih pwr shembull: Gazeta Express, Mbi 200 persona të intervistuar nga Gjykata Speciale, a do të ndodhin arrestimet e para këtë muaj, <https://www.gazetaexpress.com/mbi-200-persona-te-intervistuar-nga-gjykata-speciale-a-do-te-ndodhin-arrestimet-e-para-kete-muaj/>

vogël i individëve i janë nënshtruar këtij krimi.”⁶ Prandaj, marrja e paligjshme e organeve është një çështje që po shqyrtohet nga bashkësia botërore.

Pos kësaj, ajo kërkonte ndëshkime të vrazhda (të pamërituara) për të gjithë individët e përfshirë, pavarësisht nga pozitat e tyre zyrtare në Kosovë, duke e shpërfillur faktin që sipas Nenit 16, Pika b, e Ligjit të Kosovës për Dhomat e Gjykatës Speciale “pozita zyrtare e të akuzuarit, qoftë ai në krye të shtetit, kryeministër apo zyrtar i qeverisë, personin nuk e shkarkon nga përgjegjësia penale, dhe as nuk e lehtëson dënimin e tij,” duke dëshmuar në këtë mënyrë që pretendimi i saj nuk ka kurrfarë baze,⁷ por është një propagandë politike kundër Kosovës.

⁶ Deklaratë e Prokurorit Kryesor të Forcës Speciale Hetuese, Clint Williamson, 29 korrik 2014, https://balkaninsight.com/wp-content/uploads/2019/01/Statement_of_the_Chief_Prosecutor_of_the_SITF_EN.pdf

⁷ Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat Speciale dhe Zyren e Prokurorit Special, 31 gusht 2015, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11036>